



Фонд за здравствено осигурување на Република Северна Македонија
Fondi për sigurim shëndetësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut

08 maj, 2020

NJOFTIM

Për ISHP nga kujdesi shëndetësor specialistik - konsultativ

Institucionet shëndetësore nga kujdesi shëndetësor specialistik - konsultativ, gjatë periudhës së vlefshmërisë së masave të përkohshme, për të parandaluar përhapjen e koronavirusit nga Fondi dhe Ministria e Shëndetësisë, **iu ishte rekomanduar** t'iu ofrojnë shërbime shëndetësore të siguruarve vetëm në raste urgjente.

Sipas rekomandimeve, gjatë kësaj periudhe, institucionet e kujdesit shëndetësor nga kujdesi shëndetësor specialistik - konsultativ, me përjashtim të dializës, nuk kanë mundur të ofrojnë shërbime shëndetësore për të siguruarit në kuadër të kompensimit të caktuar mujor, që do të thotë se ata nuk kanë mundësi t'i faturojnë ato në Fond.

Prandaj, Fondi për të përmbushur nevojat e institucioneve të kujdesit shëndetësor, do të kryej pagesë paraprake për kompensimin e caktuar mujor për muajt prill, maj dhe qershor 2020, pavarësisht nga numri i shërbimeve të kryera shëndetësore të ofruara ndaj të siguruarve gjatë kësaj periudhe.

Për këtë arsye, Fondi bën ndryshime në mënyrën e faturimit të shërbimeve shëndetësore për muajt prill, maj dhe qershor 2020, për të cilat do të ofrohen udhëzime shtesë se si të faturohen muajt e specifikuar.

Afati i faturimit për muajin prill zgjatet deri më 25.05.2020.

Me respekt,
FSSHRMV